



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 323, datë 14.06.2023**

**PËR**

**KOMANDIMIN E ZNJ. {...}**

**SI NDIHMËSMAGJISTRATE NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 156, datë 29.03.2023, “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, dërguar me shkresën nr.2737/1 prot., datë 31.05.2023, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.
2. Afati i komandimit është 5 (pesë) vjet dhe fillon më datë 15.07.2023.
3. Komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit.
4. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtares znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Gjykatës së Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**